REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 234/22
Datë/Datum. 16.08.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr.234/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z.Vedat Poterqoi–Kryetar,panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga GOE "Studio LINKS 4, Nafije Gashi Ademi B.I. dhe Workspace, Aida Gashi Krasniqi, B.I" -Prishtinë, kundër njoftimit mbi dhënien e kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Hartimi i draft planit komunal të veprimit për Energji dhe Klimë", me numër të prokurimit:622-22-2273-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)– KK "Prizren" ,me datën 16.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I.Refuzohet, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik GOE "Studio LINKS 4, Nafije Gashi Ademi B.I. dhe Workspace, Aida Gashi Krasniqi, B.I" -Prishtinë, kundër njoftimit mbi dhënien e kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Hartimi i draft planit komunal të veprimit për Energji dhe Klimë", me numër të prokurimit:622-22-2273-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)– KK "Prizren".

II.Mbetet në fuqi, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Hartimi i draft planit komunal të veprimit për Energji dhe Klimë", me numër të prokurimit:622-22-2273-2-2-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)–KK "Prizren.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik GOE "Studio LINKS 4, Nafije Gashi Ademi B.I. dhe Workspace, Aida Gashi Krasniqi, B.I" -Prishtinë, refuzohet si e pa bazuar, i bëhet konfiskimi i depozitës sipas nenit 31.5 të Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit nr.83/20, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues GOE "Studio LINKS 4, Nafije Gashi Ademi B.I. dhe Workspace, Aida Gashi Krasniqi, B.I" -Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datë 27.06.2022 , me nr.234/22, kundër njoftimit mbi dhënien e kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Hartimi i draft planit komunal të veprimit për Energji dhe Klimë", me numër të prokurimit:622-22-2273-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)– KK "Prizren" , duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,nenin 4 par.1.19 dhe 7 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe
- Nenin 24.10 të RRUOPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 28.06.2022 ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt.29.06.2022, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjgje në pretendimin ankimor nr.1.

Pretendimi ankimor ka të bëjë me atë se në formularin e përshkrimit të çmimit nuk është paraqitur kolona ku duhet të paraqitet norma e TVSH-së.

AK në formularin e çmimeve në dokumentin e ngarkuar në platformën e E-prokurimit, " Paramasa dhe parallogaria- PKVEK finale", nuk ka vendosur kolonën për të paraqitur normën e TVSH-së.

Bazuar në kërkesat që dalin nga Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP), përkatësisht neni 24.10 lidhur me listën e standardizuar të çmimeve , AK është obliguar ta bëjë këtë.

Shprehimisht, nga neni i sipërpërmendur kërkohet që AK duhet të vendos fushat e shënuara për tu plotësuar nga ofertuesit, dhe ato janë si në vijim: çmimi për njësi, norma e TVSH-së , emri i prodhuesit, shënimi i ofertuesit etj,

Për më tepër, tek parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontatës, përkatësisht neni 13.38 i RRUOPP-së thuhet se :" Në raste kur ka ndryshime sipas një vendimi të një organi kompetent, në tatime, normën e TVSH-së, apo ndryshime në tarifat për import, çmimet e kontratës duhet të rregullohen në përputhje me rrethanat".

AK në dosjen e tenderit dhe në formularin e çmimit ,në asnjë rast nuk e ka dhënë arsyetimin, se pse kolona për normën e TVSH-së nuk është përfshirë.

Nga mangësitë e tilla të evidentuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë , është e pamundur të bëhet një vlerësim i drejtë , prandaj vazhdimi i këtij aktiviteti të prokurimit hap mundësinë e një shkelje të ligjit që ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi i cili mund të bëhet në këtë fazë. Prandaj, bazuar në sqarimet e mësipërme pretendimi ankimor është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar nga sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, rekomandon që të anulohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe aktiviteti të kthehet në ri-tenderim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 29.06.2022 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datën 30.06.2022 me anë të parashtresës, e ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, nuk e ka njoftuar OSHP-në se a pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Pa praninë e palëve, konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së me nr .83/20, janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues/teknik deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Lidhur me pretendimi ankimor se AK në formularin e çmimeve në dokumentin e ngarkuar në platformën e E-prokurimit, " Paramasa dhe parallogaria- PKVEK finale", AK, nuk ka vendosur kolonën për të paraqitur normën e TVSH-së dhe AK ka qenë dashur ti referohet nenit 24.10 të RRUOPP-ës. Paneli shqyrtues këtë pretendim e klasifikon si të pabazuar, për faktin se këtë pretendim ankimor, operatori ekonomik ankues ka qenë dashur ta bëjë gjatë fazës së tenderimit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se paramasa e tyre nuk ka gabime aritmetikore, paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim është i pabazuar, për shkak se, autoriteti kontraktues gabimisht e klasifikon si gabim aritmetikor, e në fakt është gabim teknik dhe me plotë të drejtë operatori ekonomik ankues është i papërgjegjshëm, sepse ka dallime në çmime në mes të përshkrimit të çmimeve me të cilin ka ofertuar dhe Formularit për Dorëzim të Tenderit. Ky fakt përveç që është e pasqyruar edhe ne ofertën e OE ankues, këtë e deklaron edhe në ankesë se çmimi i ofruar nga ta në përshkrim të çmimeve është pa TVSH. Në këto dy dokumente duhet të ketë përputhje sa i përket çmimit të ofruar dhe ky çmim duhet të ofrohet me të gjitha taksat e aplikuara, ashtu siç është e cekur edhe në Dosjet të tenderit neni "*20.1 Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€) dhe duhet të përfshinë të gjitha taksat e aplikueshme, detyrat dhe pagesat tjera.*"

Andaj, Paneli shqyrtues vlerëson se AK e ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 dhe 60 të LPP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z.Vedat Poterqoi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK "Prizren"

1x1 GOE -"Studio LINKS 4, Nafije Gashi Ademi B.I. dhe Workspace, Aida Gashi Krasniqi, B.I" -Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.